



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJAKOVËS  
OPSTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Në bazë të nenit 68, paragrafi 3, i ligjit mbi vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040 datë 04.06.2008 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28, datë: 04.06.2008), neni 4, paragrafi 1 dhe neni 6, paragrafi 1, pika 1.3 i Udhëzimit Administrativ MAPL nr. 06/2018 për standardet minimale të konsultimit me publik në Komuna i datës 31.12.2018, Drejtoria për Buxhet dhe Financa - Gjakovë me datën 17.06.2026 shpallë këtë:

### NJOFTIM

Për mbajtjen e konsultimit publik me qytetarë, dhe grupet e interesit për Kornizën Afatmesme Buxhetore, KAB 2027 – 2029.

Të nderuar bashkë qytetarë të Komunës së Gjakovës, përfaqësues të shoqërisë civile – OJQ, grupe të interesit dhe të gjithë ju të interesuar, ju njoftojmë se të mërkurën me datën 24.06.2026 me fillim nga ora 11:00, në sallën solemne të Pallatit të Kulturës do të mbahet takim i hapur me qytetarët dhe kryetarët e këshillave lokal dhe shqyrtimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore, KAB 2027 – 2029 të Komunës së Gjakovës.

Në takim do të informoheni mbi KAB-in Komunal dhe do të mund të drejtoni pyetje, kërkesa për të cilat do të ju përgjigjen te pranishmit dhe njëkohësisht kërkesat tuaja mund të përfshihen në KAB.

Pjesëmarrja juaj në këtë takim dëshmon aktivizimin qytetarë dhe përfshirjen tuaj në vendimmarrje.

Gjakovë,  
17.06.2026



Durim Halilaj  
Drejtori / Drejtorisë për Buxhet dhe Financa